

Un 195 Prot
Dt 20/04/2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 2569 / Prot.

Tiranë, më 18.4 .2024

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim.

KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT ✓

Adresa: Rruga "Vangjel Noti", Nr. 25, Laprakë, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.2, Tiranë

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr 219, Tiranë, AL

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 165, datë 16.04.2024, "Për hapjen dhe riorganizimin e njërive kryesore në Kolegjin Universitar të Biznesit".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola



Prof. Colati
Prof. Jezov
Per njohje dhe zbatim
Procedura dhe
Informacion
Rregullatore
An. Y. Beso
19/4/2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2569 Prot.

Tiranë, më 16.04. 2024

URDHËR

Nr. 165, datë 16.04.2024

PËR
HAPJEN DHE RIORGANIZIMIN E NJËSIVE KRYESORE NË KOLEGJIN
UNIVERSITAR TË BIZNESIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar, si dhe të pikës 2, të urdhrin nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj",

URDHËROJ:

1. Hapjen e njësisë kryesore "Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike", në Kolegjin Universitar të Biznesit, me përbërjen si më poshtë:
 - a) Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit;
 - b) Departamenti i Informatikës së Aplikuar në Ekonomi;
 - c) Qendra e Kërkimit, Projekteve dhe Inovacionit.

2. Riorganizimin e njësive kryesore "Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike" dhe "Fakulteti i Ekonomisë" në njësinë kryesore "Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale", në Kolegjin Universitar të Biznesit, me përbërje si më poshtë:
 - a) Departamenti i Menaxhimit;
 - b) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
 - c) Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

3. Veprimtaria akademike për njësitë kryesore "Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike" dhe "Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale" të Kolegjit Universitar të Biznesit, fillon në vitin akademik 2024-2025.
4. Kolegji Universitar i Biznesit të zbatojë procedurat e akreditimit institucional duke përfshirë këto njësi kryesore, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Kolegji Universitar i Biznesit të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës për programet e studimit që do të aplikohen për këto njësi kryesore, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar i Biznesit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

